

VENDIM
Nr.1155, datë 13.8.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS VOSKOPOJË, TË QARKUT TË KORÇËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Voskopojë, të qarkut të Korçës, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të komunës Voskopojë, të qarkut të Korçës, miratuar me vendimin nr.239, datë 25.4.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Voskopojë, të qarkut të Korçës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Voskopojë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Voskopojë

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
19-21	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
1	Prona që përdoren në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
16-18	Prona që përdoren në fushën e shëndetit publik	Në pronësi
10-11 (vetëm sheshe) 324,325,326,327,328,329	Sheshe publike, infrastrukturë rrugore	Në pronësi
13-15	Prona që përdoren në fushën kulturore sportive	Në pronësi
2-9	Shërbim funeral	Në pronësi
10-11 (vetëm troje),	Prona që përdoren në fushën e infrastrukturës. Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objektve të çfarëdo lloji	Në përdorim
22,24,26,27,29,30	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
23,25,26/1,28,31	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka inproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi
330-332	Sistemi i furnizimit me ujë të pijshëm	Në pronësi